

2022–2023 RAPORTI I ECURISË SË SHKOLLAVE PËR ARSIMIN DHE
BARAZINË

Pyetje të shpeshta (FAQs)

Pyetje të shpeshta

Çfarë është SPOTlight dhe raporti i ecurisë së shkollave për arsimin dhe barazinë (SPREE)?

SPOTlight (tabela e rezultateve të rendimentit të shkollave) dhe raporti i ecurisë së shkollave për arsimin dhe barazinë (SPREE) janë dy raporte bashkëplotësuese që School District of Philadelphia vë në qarkullim për të përmbledhur rendimentin e shkollave.

Konkretisht SPOTlight është një përmbledhje njëfaqëshe mbi rendimentin e shkollës kundrejt [objektivave](#) të Këshillit Arsimor për kushtet specifike të kërkuara për arritjen e suksesit. Këshilli Arsimor monitoron ecurinë drejt objektivave të veta gjatë gjithë vitit. Duke filluar nga viti 2022–2023, këto kushte për arritjen e suksesit (d.m.th. frekuentimi i nxënësve dhe i mësuesve, numri i braktisjeve dhe përparimi drejt diplomimit në kohë) janë monitoruar gjithashtu në baza mujore.

SPOTlight ofron gjithashtu informacion nëse rendimenti i një shkolle është përmirësuar me kalimin e kohës.

Ngjashëm SPREE raporton mbi rendimentin dhe përparimin e shkollës me kalimin e kohës. Ai ofron informacion se si shkollat - dhe grupet e nxënësve brenda shkollave - po performojnë, shqyrton përparimin me kalimin e kohës dhe përmban një gamë më të gjerë treguesish sesa SPOTlight.

Si lidhen të dy raportet me njëri-tjetrin?

SPOTlight përfshin shumë nga të njëjtat informacione që janë në SPREE. Sakaq SPREE zbërthen më tej treguesit që janë në qendër të vëmendjes sipas grupit të nxënësve. SPREE përfshin gjithashtu një gamë më të gjerë të dhënash sesa SPOTlight - për shembull, informacione mbi pezullimet e nxënësve dhe treguesit shtesë në lidhje me arsimtarët.

Çfarë do të thonë treguesit e rendimentit (ngjyrat dhe etiketat) për raportet 2022–23?

SPOTlight dhe SPREE fokusohen në mënyrën se si rendimenti i një shkolle të caktuar ka ndryshuar nga viti i kaluar. Ky ndryshim me kalimin e kohës përfaqësohet nga një nga tre treguesit e koduar me ngjyra:

- Një **tregues i gjelbër**, ose etiketa "Improving" (Përmirësim), do të thotë se shkolle ka shfaqur përmirësim të mjaftueshëm ose tashmë ka rendimentin më të mirë të mundshëm për treguesin (p.sh. pa braktisje; 100% e nxënësve të aftë në vlerësimin shtetëror).
- Një **tregues i verdhë**, ose etiketa "Maintaining" (Ruajtje vendi), do të thotë që një shkolle ka ruajtur rendimentin e vet të mëparshëm.
- Një **tregues i kuq**, ose etiketa "Not Improving" (Pa përmirësim), tregon se shkolle ka shfaqur rendiment negativ.

Këto mjete nuk janë hartuar për të treguar se si shkollat performojnë në krahasim me njëra-tjetrën.

Çfarë do të thotë të tregosh përmirësim për një tregues të caktuar?

Për të pasur "Përmirësim" të mjaftueshëm për një tregues, shkolla duhet të rritet me të paktën 1,0 përqind për shumicën e treguesve ose të bjerë me të paktën 1,0 përqind për statistikën poshtë bazës. Për braktisjet e nxënësve, numri i braktisjeve duhet të ulet me të paktën një nxënës.

Shkollat me rritje ose ulje më pak se një përqind ose pa ndryshim në numrin e braktisësve, janë duke "Ruajtur vendin" në rendiment.

Shkollat që shohin një rënie të rendimentit me të paktën 1,0 përqind ose një rritje në treguesit poshtë bazës me të paktën 1,0 përqind, shfaqen si "Pa përmirësim". Një shkollë që ka ndonjë rritje të numrit të nxënësve që braktisin shkollën konsiderohet gjithashtu se nuk po përmirësohet.

Pse disa shkolla nuk kanë SPOTlight apo SPREE?

Shkollat e arsimit alternativ, shkollat që i shërbejnë një niveli të vetëm klase brenda një konfigurimi klasash dhe shkollat Charter me status pa rinovim nuk kanë të drejtë të marrin SPREE. Për shembull, YouthBuild Philadelphia Charter School i plotësoi të gjitha kërkesat për të marrë SPREE, por ishte e papërshtatshme për shkak të diapazonit të saj të kufizuar të viteve të klasave (vetëm klasa 12) dhe modelit unik të shkollës.

Për më tepër, jo të gjitha shkollat Charter zgjedhin të marrin pjesë në SPREE.

Cilat shkolla Charter morën pjesë?

Publikimi i këtij viti përfshin afërsisht 99% të të gjitha shkollave Charter të pranueshme që operojnë në 2022–2023 - ose të gjitha shkollat

Charter të pranueshme përveç njëres. Pjesëmarrësit e shkollës Charter vlerësojnë një krahasim mes të ngjashmëve të ecurisë në të gjitha shkollat e qytetit dhe vlerësojnë pamjen gjithëpërfshirëse të rendimentit dhe ecurisë së shkollës të pasqyruar në SPREE.

A përfshijnë SPOTlight dhe SPREE nxënës që janë të regjistruar në programe arsimore alternative?

Nxënësit e regjistruar në programet alternative të arsimit (që u shërbejnë të rinjve jashtë shkollës, nxënësit që janë në rrezik të madh për braktisjen e shkollës dhe nxënësit që janë subjekt i transferimit disiplinor ose i përjashtimit) përjashtohen nga të gjitha llogaritjet e treguesve për raportet SPREE dhe SPOTlight të shkollës së lagjes së tyre.

Rendimenti i secilit program alternativ pasqyrohet në [Alternative Education Progress Reports \(AEPR\)](#) që publikohet çdo vit.

Pse nuk ofrohen të dhëna mbi rendimentin e një shkolle dhe/ose nëse shkolla është përmirësuar?

Të dhënat për vitin aktual (2022–2023) mund të mos jenë të disponueshme për disa shkolla për disa arsye, mes të cilash:

- Një numër i vogël nxënësish kualifikoheshin për treguesin në vitin e kaluar (p.sh. një shkollë që kishte 15 nxënës të klasës së tretë nuk do të merrte rezultat për treguesit PSSA ELA ose Matematikë, të klasës së 3-të).
- Shkollat nuk ofruan programin apo kursin specifik të nevojshëm për treguesin (p.sh. Karriera dhe Edukimi Teknik).

- Disa tregues nuk janë përfshirë për sektorë të veçantë (p.sh. Frekuentimi i mësuesve nuk raportohet për asnjë shkollë Charter).

Ka gjasë që të dhënat nëse një shkollë është përmirësuar mund të mos jenë të disponueshme për disa arsye të mëtejshme, mes të cilash:

- Treguesit nuk mund të llogariteshin për vitin e kaluar për shkak të rrethanave specifike, si masat në lidhje me COVID ose mbylljet e shkollave.
- Shkollat nuk ishin të hapura vitin e kaluar.

Pse përdoren rezultatet Keystone të 2018–2019 për raportet e shkollave të mesme?

Rezultatet Keystone për vitin 2022–2023 krahasohen me rendimentin e vitit 2018–2019 (para pandemisë) për të përcaktuar ecurinë e shkollës. Ky krahasim është për shkak të anulimeve dhe të përjashtimeve të analizave të lidhura me pandeminë për shumë vite. Rezultatet e 2018–2019 pasqyrojnë vitin më të fundit në të cilin kushtet dhe kërkesat e provimeve ishin të krahasueshme me nxënësit që ishin në klasën e 11-të në 2022–2023.

Si ndryshon SPREE e këtij viti nga SPREE që u publikua për vitin shkollor 2021–2022?

Raporti SPREE 2022–2023 duket ndryshe nga raporti i krijuar për 2021–2022 në disa aspekte kryesore:

Për t'u përshtatur me fokusin në „Kushtet për sukses“ dhe qëllimet akademike që monitorohen rregullisht nga kryembikëqyrësi dhe Këshilli Arsimor, SPREE 2022–2023 shton disa tregues, duke përfshirë rendimentin "nën bazë" në

vlerësimet e shtetit, rendimentin specifik sipas lëndëve në vlerësimet shtetërore për nxënësit e shkollave të mesme dhe braktisësit. Ai gjithashtu heq shumë tregues, si p.sh. ata që lidhen me anketën e përvojës së shkollës së Filadelfisë, zhvillimin e nxënësve në testet e standardizuara shtetërore dhe disa tregues të gatishmërisë për universitet dhe karrierë.

Për më tepër, raporti 2022–2023 fokusohet në përmirësim, jo në rendiment kundrejt objektivave vjetore, pasi Këshilli Arsimor po rregullon objektivat e tij për të marrë parasysh pandeminë COVID-19. Si rezultat, shkollat nuk mund të marrin nivelet e përgjithshme për vitin 2022–2023.

Cilat janë implikimet e këtyre mjeteve për një shkollë?

Këto dokumente synohen si mjet informues për një shkollë dhe komunitetin e saj. Ato janë përmbledhje të nivelit të lartë dhe efikase të rendimentit dhe të përmirësimit në mbarë shkollën.

Si performojnë shkollat në raport me njëra-tjetrën në SPOTlight dhe SPREE?

Si SPOTlight, ashtu dhe SPREE fokusohen në mënyrën se si po funksionon një shkollë e caktuar dhe se si ka ndryshuar nga viti i kaluar. SPREE tregon gjithashtu se si një shkollë po funksionon për grupet e ndryshme të nxënësve që ajo shërben. Këto mjete nuk synojnë të tregojnë se si shkollat performojnë në krahasim me njëra-tjetrën.

Si llogaritet SPREE për nxënësit që mësojnë anglisht ose nxënësit që marrin shërbime të arsimit të posaçëm?

Shumë nga treguesit në SPREE shfaqen veçmas për grupet e nxënësve, duke përfshirë nxënësit që mësojnë anglisht dhe ata që marrin shërbime të arsimit të posaçëm.

Për shkollat që u shërbejnë një popullate mjaft të madhe të grupeve specifike nxënësish, SPREE përfshin gjithashtu informacion mbi përqindjen e treguesve që shkolla po përmirëson për çdo grup nxënësish të përfshirë. Në shumicën e viteve, SPREE përfshin gjithashtu një vlerësim të përgjithshëm të rendimentit të shkollës për çdo grup nxënësish të përfshirë.

Si llogariten treguesit për nxënësit që transferohen ndërmjet shkollave të ndryshme?

Çdo tregues ka rregulla të ndryshme për të cilat përfshihen nxënësit. Për shembull, për rezultatet e vlerësimit shtetëror (PSSA dhe Provimet Keystone), raporti i një shkolle përfshin të gjithë nxënësit që Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë (PDE) i identifikon si atribuar shkollës.

Për tregues të tjerë, si mungesat dhe pezullimet, SPOTlight dhe SPREE e shkollës përfshijnë vetëm rastet që kanë ndodhur në shkollë. Kjo praktikë siguron që shkollat të mbajnë përgjegjësi vetëm për sjelljen ose rezultatet brenda shkollës së tyre. Për shembull, nëse një nxënës pezullohet në shkollën e parë, transferohet dhe nuk pezullohet në shkollën e dytë, pezullimi përfshihet vetëm për raportin e shkollës së parë.

Një proces i ngjashëm përdoret për nxënësit që kanë braktisur shkollën. Një nxënës që kalon nga

një shkollë në një tjetër dhe më pas e braktis shkollën e dytë llogaritet vetëm një herë - në treguesin e shkollës së dytë.

Informacion më të detajuar se cilët nxënës përfshihen ose nuk përfshihen në secilin tregues mund të gjenden në manualin dhe rregullat e biznesit publik në [faqen e internetit qarkut për SPREE](#).

Si llogaritet përqindja e diplomimit për nxënësit që marrin shërbime të arsimit të posaçëm deri në moshën 21 vjeç?

Përqindja e diplomimit të grupit katërvjeçar përfshin të gjithë nxënësit që hynë në shkollën e mesme në vitin e grupit (për raportin 2022–2023, nxënësit që hynë për herë të parë në klasën e nëntë në vitin shkollor 2019–2020). Nxënësit që marrin shërbime të arsimit të posaçëm deri në moshën 21 vjeç përfshihen në këtë përqindje, në përputhje me udhëzimet federale dhe shtetërore për mënyrën se si llogariten përqindjet e diplomimit në grup.

Si vlerësohen shkollat kur të dhënat e vitit të kaluar nuk ofrohen?

Nëse të dhënat e vitit të kaluar nuk ofrohen për një tregues, shfaqet rendimenti i vitit aktual i shkollës, por nuk përfshihet vlerësimi (p.sh. "Me përmirësim" apo "Pa përmirësim").

A ka më shumë informacion se si llogaritet secili tregues?

Përveç përkufizimeve të treguesve të dhëna në manual, rregullat e biznesit publik për çdo llogaritje janë në [faqen e internetit të qarkut për SPREE](#). Këto rregulla synojnë të ofrojnë një

përmbledhje të nivelit të lartë të asaj që përfshihet në secilin tregues, duke përfshirë burimin e të dhënave, cilët nxënës janë përfshirë në llogaritje dhe cilat shkolla kualifikohen për një tregues.

Pse rezultatet e treguesve në SPOTlight dhe SPREE mund të ndryshojnë nga informacioni i ngjashëm i shpërndarë diku tjetër?

Ka disa arsye pse SPREE mund të shfaqë informacione të ndryshme kur krahasohet me burime të tjera, duke përfshirë:

- **Mostra e nxënësve** – SPREE ndonjëherë pasqyron një mostër të ndryshme nxënësish nga burimet e tjera të të dhënave, si p.sh. indeksi i gatishmërisë për të ardhmen i Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë (FRI) apo sistemi i brendshëm i informacionit të një shkolle. Për shembull, treguesit PSSA në SPREE pasqyrojnë rendimentin e nxënësve që u regjistruan për një vit të plotë akademik; megjithatë, një shkollë individuale mund të jetë në gjendje të shohë rezultate për të gjithë nxënësit që janë vlerësuar në ndërtesë, pavarësisht se sa kohë janë regjistruar në shkollë.
- **Llogaritja e kohës** – Burime të tjera mund të shikojnë në një periudhë të ndryshme nga SPREE. Për shembull, përqindja e matrikullimit në universitet në fillim të vjeshtës e shfaqur në SPREE 2022–2023 pasqyron regjistrimin e vjeshtës 2023 të nxënësve që u diplomuan në 2022–2023. Por përqindja e matrikullimit e shfaqur në FRI "mbetet pas" me një vit - domethënë, norma e matrikullimit në FRI 2022–2023 pasqyron regjistrimin e nxënësve që u diplomuan në 2021–2022.

- **Përkufizimi i treguesit** - Treguesit në SPREE mund të llogariten pak më ndryshe se treguesit e ngjashëm të paraqitur tjetërkund. Për shembull, treguesi i frekuentimit në SPREE pasqyron përqindjen e nxënësve që ndjekin një përqindje të caktuar ditësh (p.sh. 90% ose më shumë të ditëve mësimore), ndërsa një llogaritje frekuentimi e publikuar nga një agjenci partnere mund të pasqyrojë një llogaritje tjetër, si p.sh. frekuentimin mesatar ditor.

Pse disa shkolla kanë dy SPOTlight dhe dy SPREE?

Duke qenë se qëllimet e Këshillit Arsimor janë specifike për nivele të caktuara të klasave, SPOTlight dhe SPREE vlerësojnë rezultatet e nxënësve për grupe të caktuara notash. Kështu, shkollat që përfshijnë si klasat e nivelit të ulët dhe të mesëm marrin raporte të veçanta për secilin grup të klasës në mënyrë që rezultatet e nxënësve të mund të vlerësohen veçmas. Për shembull, një shkollë që përfshin klasat 5–12 do të marrë një raport shkolle të mesme (për klasat 5–8) dhe një raport shkolle të mesme (për klasat 9–12).

Pse nuk ka të dhëna të grupit të nxënësve të viteve të mëparshme për treguesit Keystone?

Të dhënat Keystone të vitit të kaluar (2018–2019) vijnë nga faja e internetit e PDE pasi të dhënat e nevojshme nuk ishin të disponueshme në ndonjë formë tjetër. Megjithatë, PDE nuk përfshin rendimentin e grupeve individuale të nxënësve në dosjet që publikon në faqen e vet të internetit; në vend të kësaj, PDE përfshin vetëm nxënësit që konsiderohen si "Historikisht me rendiment të dobët".

Ku mund të gjej informacione të mëtejshme në lidhje me shkollën time dhe rendimentin e shkollës sime?

Qarku ka një sërë burimesh që ofrojnë informacion të mëtejshëm për shkollat, duke përfshirë:

- **School Profiles** – Faqja e internetit [School Profiles](#) (Profilet e shkollave) e qarkut jep informacion për çdo shkollë individuale dhe për qarkun në tërësi. Faqet e shkollës përfshijnë informacione kontakti dhe detaje në lidhje me regjistrimin dhe rendimentin e nxënësve. Faqja gjithashtu lidhet me buxhetet e shkollave dhe dokumente të tjera kyçe.
- **Philly School Experience Survey** – Anketa e përvojës së shkollës e Filadelfisë (PSES) administrohet çdo vit për nxënësit, stafin e shkollës dhe familjet. [Përmbledhjet në nivel shkolle](#) të përgjigjeve krijohen për secilën shkollë dhe [një faqe interaktive interneti](#) mundëson shqyrtimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve individuale.